



Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Enkeleda Shehi, takohet me drejtorët e shoqërive të sigurimit

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar - shtator 2013

Vijon në faqen 2

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillimet në ligjin e fondeve të pensioneve dhe mbikëqyrjen (2-4 tetor 2013)

Vijon në faqen 3

Takimi i gjashtë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (7-8 tetor 2013)

Vijon në faqen 4

Mbledhje e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Insurance Group (9-10 tetor 2013)

Vijon në faqen 5

Aplikimi i teknikave të menaxhimit të riskut në sigurime (6-11 tetor 2013)

Vijon në faqen 6

Tryezë diskutimi mbi zbulimin dhe parandalimin e mashtrimeve në sigurime (10-11 tetor 2013)

Vijon në faqen 7



Konferenca “Siguria rrugore për një Shqipëri evropiane” (17 tetor 2013)

Vijon në faqen 7

Konferenca e 20-të vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të IAIS (16-19 tetor 2013)

Vijon në faqen 8

Sfidat e ardhshme për rregullatorët e letrave me vlerë dhe zgjidhjet praktike në përballjen me këto sfida (22-25 tetor 2013)

Vijon në faqen 9

LAJMET NGA RAJONI

Azerbajxhan

Vijon në faqen 11

Estoni

Vijon në faqen 11

Greqi

Vijon në faqen 11

Hungari

Vijon në faqen 12

Letoni

Vijon në faqen 12

Turqi

Vijon në faqen 13

AMF, do të marrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim ruajtjen e parametrave teknikë të shoqërive

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Enkeleda Shehi, takohet me drejtorët e shoqërive të sigurimit

Në datë 2 tetor 2013, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes financiare, znj. Enkeleda Shehi zhvilloi një takim me drejtorët e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës për të diskutuar një sërë problematikash që lidhen kryesisht me produktin e sigurimit të detyrueshëm motorik (MTPL), në drejtim të tarifave të zbatuara, të pagesës së dëmshpërblimeve, si dhe problemeve që tregu është duke hasur me sistemin gjyqësor.

Nisur nga gjendja aktuale, kur tarifat e zbatuara kanë pësuar luhatje të shpeshta dhe vlerësohen se janë në nivele jo të përshtatshme në raport me risqet që karakterizojnë produktin, znj. Shehi vuri theksin që AMF, do të marrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim ruajtjen e parametrave teknikë të shoqërive.

Një tjetër çështje që u trajtua në takim ishte ajo e problematikës me Fondin e Kompensimit, e cila ndikohet dhe nga numri i lartë i automjeteve të pasiguruara. AMF u tregua e gatshme të mbështesë nisma ligjore dhe institucionale, si dhe të rifreskojë nismat e ndërmarra deri tani, në mënyrë që ky fenomen negativ, që përbën kosto për të gjithë sistemin dhe të siguruarit, të reduktohet.

Në përfundim, Kryetarja Shehi bëri një pasqyrim të zhvillimeve apo ecurisë teknike për mundësimin e zbatimit të sistemit bonus/malus. Aktualisht AMF është duke bërë përpjekje institucionale me DPGJC dhe AKSHI, për të mundësuar lidhjen e nevojshme në nivel TI për marrjen e numrit personal, në mënyrë që t'i mundësohet tregut shfaqja e të dhënave për të filluar tarifimin me bazë risku. Kjo është një hallkë tepër e rëndësishme për ecurinë e mëtejshme të projektit.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2013

Tregu i sigurimeve u ul me 9.28% në janar-shtator 2013. Vlera e primit të shkruar bruto në periudhën janar-shtator 2013 arriti në 5.92 miliardë lekë, ndërsa numri i policave të sigurimit pati një ulje prej 3.05% dhe arriti në 757,328 polica sigurimi.

Sigurimi i Jo-Jetës u ul me 11.85% në janar-shtator 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 11.15%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, dëmet e paguara bruto regjistruan një ulje prej 2.94% në krahasim me periudhën janar-shtator 2012.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Sigurimi i detyrueshëm për periudhën janar-shtator 2013 përbën 45.84% të tregu të sigurimeve të Jo-Jetës. Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën 2.70 miliardë lekë, me një ulje prej 17.31%, krahasuar me janar-shtator 2012.


Jo-Jeta, të tjera

Klasa të tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës përbëhen nga *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 22.26% të tregut të Jo-Jetës.

Klasat, *sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme*, së bashku zunë 14.49% të tregut të Jo-Jetës.

Tregu i sigurimeve u ul me 9.28% në janar-shtator 2013

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2013



ZHVILLIME TË TJERA

Takim mbi zhvillimet në ligjin e fondeve të pensioneve dhe mbikëqyrjen

Banka Qendrore e Holandës (*De Nederlandsche Bank*) zhvilloi në 2-4 tetor në Amsterdam, Holandë takim mbi “Zhvillimet në ligjin e fondeve të pensioneve dhe mbikëqyrjen”. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore.

Temat kryesore që u trajtuan, të prezantuara nga drejtues të nivelit të lartë dhe ekspertë të Bankës Qendrore të Holandës kishin të bënin kryesisht me: sistemin dhe bazën ligjore të pensioneve të Holandës; vlerësimin e risqeve të fondeve të pensionit, si dhe vlerësimin e investimeve të fondeve të pensionit për secilin lloj investimi të lejuar.

Vëmendje e veçantë ju kushtua situatave në kohë krize dhe ndikimit të krizave në asetet e fondit të pensionit duke analizuar se si krizat ekonomike ndikojnë në secilin investim të fondit të pensionit

Gjatë takimit u prezantua sistemi i pensioneve në Holandë, si dhe baza ligjore që e rregullon këtë sistem duke i kushtuar rëndësi mbikëqyrjes me bazë parimesh dhe kryesisht parimit të personit të kujdesshëm “*prudent person principle*”. Ekspertë të veçantë për secilin lloj investimi të fondeve të pensionit prezantuan mënyrën e vlerësimit të investimeve, si dhe risqet që secili investim paraqet në asetet e fondit.

Vëmendje e veçantë ju kushtua situatave në kohë krize dhe ndikimit të krizave në asetet e fondit të pensionit duke analizuar se si krizat ekonomike ndikojnë në secilin investim të fondit të pensionit.

Në përfundim të takimit u trajtuan raste studimore ku pjesëmarrësit, duke pasur shembull pasqyrat financiare të një fondi pensioni, “*stress tests*” krijuan situata të ndryshme në kohë krize. Në bazë të këtyre situatave analizuan se cili nga investimet do të ndikohej më shumë dhe si do të prekeshin asetet e fondit. Pjesëmarrësit llogaritën ndikimin e këtij investimi në kapitalet e veta dhe në treguesit kryesor të fondit.

Zhvillohet takimi i gjashtë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimeve të Malit të Zi (ISA) zhvilluan në 7-8 tetor 2013 në Budva, Mali i Zi takimin e gjashtë rajonal të mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE), në kuadër të iniciativës CESEE ISI, për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mbikëqyrësve të sigurimeve nga këto vende.



Në takim u diskutuan çështje të rëndësishme lidhur me tregjet

e sigurimeve, kërkesat specifike që duhet ta plotësohen nga menaxherët për shoqëritë e sigurimeve, luftën kundër pastrimit të parave, rolin e mbikëqyrësve në sigurime dhe rolin e auditit të jashtëm në sigurime. Gjatë takimit u theksua rëndësia e madhe që autoritetet mbikëqyrëse duhet t'i kushtojnë momentit të miratimit të drejtuesve të shoqërive të sigurimit, duke kërkuar që ata të jenë sa më të kualifikuar dhe me integritet të lartë moral. Edhe gjatë procesit të inspektimit i kushtojnë rëndësi performancës së drejtuesve.

Autoritetet mbikëqyrëse duhet t'i kushtojnë rëndësi miratimit të drejtuesve të shoqërive të sigurimit, duke kërkuar që ata të jenë sa më të kualifikuar dhe me integritet të lartë

Pjesëmarrësit e takimit të gjashtë rajonal

Këto takime kanë shërbyer gjithnjë si platforma për shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave të autoriteteve rregullatore nga vendet e rajonit lidhur me çështjet specifike me të cilat përballet tregu i sigurimeve.

Mbledhje e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Insurance Group

Autoriteti Austriak i Mbikëqyrjes (*FMA*), zhvilloi në 9-10 tetor 2013, në Vjenë, Austri mbledhjen e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë *UNIQA Insurance Group (UIG)*, 2013.

Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të Autoritetit Austriak të Mbikëqyrjes (*FMA*), si organizator i këtij takimi, si dhe përfaqësues të autoriteteve rregullatore të vendeve ku shoqëria UNIQA operon me filialet e saj.

Drejtuesit e lartë të *UIG*, prezantuan performancën, strategjinë, si dhe risqet aktuale me të cilat përballet Grupi UNIQA në vendet ku ata kanë shtrirë aktivitetin e tyre. Takimi u organizua në formën e pyetjeve dhe diskutimeve në tavolinë të rrumbullakët ku secili vend prezantoi dhe komentoi të dhënat e përfshira në formatin e vlerësimit të riskut për filialet e UNIQA-s në vendin e tij, i cili ishte standard për të gjithë rregullatorët.

Çështjet që u diskutuan ishin përmbledhur në formatin përkatës dhe konsistonin në disa drejtime kryesore:

- Ndryshimet në strukturën e shoqërisë, në *market share*, etj;
- Aftësia paguese e shoqërisë, e detajuar për periudhat 31.12.2012 dhe 30.06.2013, duke specifikuar edhe ndryshime të rëndësishme që mund të kishin ndodhur gjatë këtyre periudhave;
- Transaksionet ndërmjet grupit në drejtim të huave, kontratave të garancive, kontratave të risigurimit, etj, në fokusin e ndonjë transaksioni të dyshimtë apo të veçantë;
- Treguesit kryesorë të aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike për periudhat 31.12.2012 dhe 30.06.2013.

Informacioni i mësipërm shërbente për të bërë vlerësimin e riskut të shoqërisë UNIQA sipas rregullatorëve përkatës, fokusuar në kategori të veçanta të riskut, si risk makroekonomik, ligjor, shtetëror, etj. Nga ana tjetër, Autoriteti Austriak i Mbikëqyrjes (*FMA*), në kuadër të ekspozimit të Grupit UNIQA në tregun e sigurimeve prezantonte për çdo vend të dhëna makroekonomike që ndikonin në vlerësimin e riskut të këtij grupi duke konkluduar me një rezultat sipas kategorisë së riskut *low, moderate ose high* dhe sipas vendeve.

Autoriteti Austriak i Mbikëqyrjes (*FMA*), në kuadër të ekspozimit të Grupit UNIQA në tregun e sigurimeve prezantonte për çdo vend të dhëna makroekonomike që ndikonin në vlerësimin e riskut të këtij grupi duke konkluduar me një rezultat sipas kategorisë së riskut *low, moderate ose high* dhe sipas vendeve

Takim mbi aplikimin e teknikave të menaxhimit të riskut dhe të kuptuarit të modeleve të brendshme

Instituti për Stabilitetin Financiar (*Financial Stability Institute, FSI*) zhvilloi në 6-11 tetor 2013, në Beatenberg takimin “Mbi aplikimin e teknikave të menaxhimit të riskut dhe të kuptuarit të modeleve të brendshme (*Internal Models*)”. Në këtë takim merrnin pjesë aktuarë, si dhe drejtues të autoriteve mbikëqyrëse të sigurimeve të vendeve të ndryshme.

Temat kryesore të trajtuara në këtë takim nga profesorë, konsulentë, si dhe drejtues departamentesh të tregut të sigurimeve, risigurimeve dhe rregullatorëve nga Italia, Zvicra, Gjermania dhe Britania e Madhe, ishin:

- Përdorimi i modeleve të brendshme financiare;
- Përdorimi praktik mbi modelet e brendshme të menaxhimit të riskut për kontratat e pasurisë dhe aksidenteve, sipas programit të sofistikuar *Igloo*;
- Bazat e menaxhimit të riskut për shoqëritë e sigurimeve;
- Modelet matematikore të analizimit të riskut si korrelacioni linear dhe kopula;
- Menaxhimi i pasigurive në një treg kompleks, të pasigurtë;
- Qeverisja e modeleve të brendshme nga perspektiva e sektorit publik;
- Përshkrimi i një shembulli mbi modelet e brendshme në sigurimin e Jetës;
- Validime praktike të modeleve të brendshme.

Gjatë takimit u diskutua lidhur me kushtet teknike të nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes me Fokus Risku për sigurimin e katastrofave si kapitali ose niveli i rezervave të përshtatshme dedikuar sigurimit të katastrofave; identifikimi i zonave me mundësi të lartë të ndodhjes së dëmeve me shkaqe natyrore, si dhe grupet e përshtatshme të specialistëve që mundësojnë matjen dhe identifikimin e këtij risku.

Një moment i rëndësishëm ishte dhe prezantimi i një prej programeve më të sofistikuar të menaxhimit të riskut - *Igloo*, i cili fillonte nga analizimi i riskut të produkteve që dilnin në treg deri tek analizimi i pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit. Programi jepte mundësinë e identifikimit të riskut, si dhe lehtësinë e marrjes së vendimeve mbi masat e eliminimit të riskut.

Rëndësi të veçantë ju dedikua të dhënave dhe cilësisë së tyre në mënyrë që këto modele të japin rezultate të sakta.

Temat e trajtuara, si dhe diskutimet e mbajtura, patën rëndësi në njohjen e metodave të përdorura nga aktualët, si dhe analistët e menaxhimit të riskut, lidhur me vlerësimin e riskut, sinjalet paralajmëruese të situatave kritike (me nivel të lartë risku) gjatë punës së aktuarit, si dhe masat menaxhuese të situatave të tilla.

Tryezë diskutimi mbi zbulimin dhe parandalimin e mashtrimeve në sigurime

Qendra e Ekselencës Financiare e Sllovenisë në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sigurime të Sllovenisë organizuan në 10-11 tetor në Ljubjanë, Slloveni një tryezë diskutimi mbi zbulimin dhe parandalimin e mashtrimeve në sigurime me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga autoritetet rregullatore të vendeve të Ballkanit



Pjesëmarrësit e tryezës së diskutimit

Perëndimor dhe ekspertë të tjerë të fushës së sigurimeve.

Objekti kryesor i programit ishte trajtimi i çështjeve që lidhen me koordinimin e përpjekjeve për zbulimin dhe parandalimin e rasteve të mundshme të mashtrimeve në sigurime. Gjatë tryezës së diskutimit u bënë prezantime nga ekspertë të institucioneve të ndryshme si Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Sigurimet Evropiane (Insurance Europe), etj. Prezantimet trajtonin përvojën e vendeve evropiane mbi zbulimin e parandalimin e mashtrimeve. Në prezantimin e tij, Peter Cooke, përfaqësues i sekretariatit të IAIS-it theksoi se Principet Bazë të Sigurimeve, ICP 21 dhe ICP 22 janë tërësisht të lidhura me luftën kundër mashtrimeve dhe efektet që sjell zbatimi i tyre.

Në diskutime u trajtua edhe etapat e ndryshme në përballjet me mashtrimet në sigurime që nga mundësitë e zbulimit, krijimi i strukturave të brendshme apo të jashtme për gjetjen e mashtrimeve, krijimi dhe forcimi i një baze të plotë të dhënash për mashtrimet dhe përdorimi edhe i investigimve në rrjetet sociale online, analizat analitike, mundësitë që ekzistojnë brenda ligjit për luftën kundër mashtrimeve, etj.

Zhvillohet konferenca “Siguria rrugore për një Shqipëri evropiane”

Në 17 tetor, Universiteti POLIS dhe Shoqata Austriake në Shqipëri organizuan konferencën mbi sigurinë rrugore në Shqipërinë evropiane. Konferenca synonte të evidentonte eksperiencën austriake lidhur me sigurinë në trafik, të diskutonte sfidat e sigurisë rrugore në Shqipëri, si dhe të zhvillonte një bashkëpunim të mëtejshëm midis dy vendeve për të rritur sigurinë rrugore në vend.

Përfaqësuesi i sekretariatit të IAIS-it theksoi se Principet Bazë të Sigurimeve, ICP 21 dhe ICP 22 janë tërësisht të lidhura me luftën kundër mashtrimeve dhe efektet që sjell zbatimi i tyre

Z. Mati Pepa theksoi se kërkohet rritja e cilësisë së produkteve të sigurimit motorik të ofruara nga shoqëritë e sigurimit; miratimi i ndryshimeve ligjore për disa prej problematikave të sigurimeve të detyrueshme në vend

Pjesëmarrës në konferencë ishin zyrtarë të lartë të Qeverisë, Ministri i Transportit z. Edmond Haxhinasto, Ministri i Brendshëm, z. Saimir Tahiri, drejtues të institucioneve austriake të sigurisë rrugore, përfaqësues të sektorit të sigurimeve në Shqipëri dhe në Austri, akademikë dhe ekspertë të fushës, etj.

Në panelin e dytë të konferencës, diskutoi edhe z. Mati Pepa, Nënkryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në Shqipëri lidhur me kontributin që industria e sigurimeve duhet të japë në drejtim të sigurisë rrugore. Në fjalën e tij z. Pepa bëri një pasqyrë të industrisë së sotme të sigurimeve në vend dhe evidentoi rrugët për të rritur sigurinë në rrugë nëpërmjet sigurimeve. Ai theksoi se kërkohet rritja e cilësisë së produkteve të sigurimit motorik të ofruara nga shoqëritë e sigurimit; miratimi i ndryshimeve ligjore për disa prej problematikave të sigurimeve të detyrueshme në vend, duke përfshirë këtu edhe ligjin e ri të sigurimeve i paraqitur në parlament nga AMF, i cili do të mundësonte ndër të tjera edhe përmirësimin e mbikëqyrjes duke kaluar në atë me bazë rrisht. Z. Pepa evidentoi punën dhe projektet e realizuara nga AMF për të lidhur me mirë primet e sigurimit që ato të reflektojnë riskun duke konsideruar edhe elementë shtesë kur përcaktohet primet siç janë mosha dhe gjinia e të siguruarit, vendndodhja dhe sidomos historiku i tij i dëmeve të mëparshme.

Eksperiencat austriake që u prezantuan në konferencë pasqyruan edhe drejtime zhvillimi të mëtejshëm, të cilat mund të ndiqen nga autoritetet homologe shqiptare për të rritur sigurinë në rrugë.

Zhvillohet Konferenca e 20-të vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime, IAIS

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi gjatë periudhës 16-19 tetor 2013, në Taipei, Kinë, Konferencën e 20-të Vjetore me temë “Ndërtimi i mbikëqyrjes së qëndrueshme në sigurime në një botë që ndryshon”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin mbi 600 përfaqësues nga autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve, ekspertë dhe zyrtarë të lartë të organizatave ndërkombëtare. E themeluar që në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e sigurimeve në më shumë se 200 juridiksione në gati 140 vende të botës.



Ndër diskutimet kryesore të Konferencës Vjetore - 2013 ishin:

- Mbikëqyrja në sigurime dhe stabiliteti financiar;
- Mplakja e popullsisë: mundësitë dhe sfidat;
- Mbikëqyrja aktive, si dhe edukimi drejt mbikëqyrjes efektive;

- Rugët e ndryshme për rritjen e aksesit në sigurime - partneriteti midis *IAIS* dhe *A2ii* (organizata ndërkombëtare - Akses tek Iniciativat në Sigurime, *ang. Access to Insurance Initiative*);
- *ComFrame* (Kuari i Përbashkët i kërkesave për mbikëqyrjen ndërkombëtare, *eng. Common Framework*) dhe mbikëqyrja e grupeve;
- Kuadri për mbrojtjen e konsumatorit dhe Fondet e Garancive.

Ndër çështjet që tërhoqën më shumë diskutime ishte edhe ndikimi i ndryshimeve globale të klimës e katastrofat mbi industrinë e sigurimeve dhe reagimi që mbikëqyrja duhet të ketë lidhur me to. Vend të veçantë në diskutime pati edhe shkëmbimi i eksperiencave të ndryshme midis autoriteteve mbikëqyrëse në funksion të përmbushjes së objektivave të tyre kryesorë. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate, u përfaqësua në këtë aktivitet nga delegacion i nivelit të lartë.

Konferenca e 21 Vjetore do të mbahet në tetor 2014 në Amsterdam.

Të ecësh përpara: Sfidat e ardhshme në rregullatorin e letrave me vlerë dhe zgjidhjet praktike për përmbushjen e këtyre sfidave

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi gjatë periudhës 22-25 tetor në Madrid seminarin me temë “Të ecësh përpara: Sfidat e ardhshme për rregullatorët e Letrave me Vlerë dhe zgjidhjet praktike për përmbushjen e këtyre sfidave”. Ky është një seminar i përvitshëm që organizohet nga IOSCO për të mbështetur vendet anëtare për një edukim gjithëpërfshirës, bazuar edhe në analizat e situatave konkrete.

Gjatë seminarit u trajtuan çështjet e lidhura me sfidat e rregullatorëve të tregut të letrave me vlerë sidomos pas mësimave të nxjerra nga kriza e fundit financiare.

Edukimi dhe mbrojtja e investitorëve ishte një temë që u trajtua gjerësisht. Në panele të ndryshme u diskutua dhe u shkëmbyen eksperiencat e rregullatorëve të ndryshëm për çështje si:

- Çfarë është edukimi i investitorëve;
- Pse është i rëndësishëm edukimi i investitorëve në krizën financiare globale;
- Roli që duhet të luaj rregullatori në promovimin e edukimit të investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
- Si mundet që investitorët t'i shmangin mashtrimet;

Ndër çështjet që tërhoqën më shumë diskutime ishte ndikimi i ndryshimeve globale të klimës e katastrofat mbi industrinë e sigurimeve dhe reagimi që mbikëqyrja duhet të ketë lidhur me to

Një rëndësi të madhe ju kushtua bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis rregullatorëve të ndryshëm dhe organizatave brenda vendit në investigimin e rasteve të abuzimeve me tregun dhe në përdorimin e teknologjisë së informacionit në zbulimin e abuzimeve

- Roli dhe sfidat e rregullatorëve dhe të vetë IOSCO-s lidhur me edukimin e investitorëve.

Një ndër temat që u trajtua gjerësisht lidhej me manipulimet e tregut. Gjatë prezantimeve dhe diskutimeve në panele, u fol për sanksionet që duhen marrë në rastin e verifikimit të abuzimeve në këto tregje. Rregullatorë nga vende të ndryshme si Emiratet e Bashkuara Arabe e Hong Kong sollën përvojat e tyre për metodologjinë dhe objektivat që ata kanë gjatë investigimit, duke i përshkruar me shembuj konkretë. Një rëndësi të madhe ju kushtua bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis rregullatorëve të ndryshëm dhe organizatave brenda vendit në investigimin e rasteve të abuzimeve me tregun dhe në përdorimin e teknologjisë së informacionit në zbulimin e abuzimeve. Prezantimet veçuan edhe rolin e rëndësishëm dhe përfitimet që vijnë në këtë drejtim nga nënshkrimi dhe përdorimi i marrëveshjeve të përbashkëta të mirëkuptimit, (MMoU) në kuadrin e IOSCO-s.

LAJMET NGA RAJONI

Azerbajxhan

www.xprimm.com

Pavarësisht kushteve të vështira ekonomike të shkaktuara nga kriza globale, tregu i sigurimeve i Azerbajxhanit vazhdon të rritet në të gjitha drejtimet. Kjo tendencë tregohet nga rezultatet pozitive për gjashtëmuorin e parë të vitit 2013, me rritje prej 16,86% (në monedhën vendase), si dhe ndryshimet legislative dhe projektet ambicioze për të ardhmen.



Tregu i sigurimeve i Azerbajxhanit vazhdon të rritet

Sipas kryetarit të Shoqatës së Siguruesve të Azerbajxhanit, Orkhan Bayramov, në ditët e sotme njerëzit në Azerbajxhan kanë tendencë për të bërë kursime duke kryer sigurim vullnetar të Jetës. Kjo tendencë është kryesisht për shkak të kompensimit në taksa që siguron legjislacioni në këto raste. Shoqatat e siguruesve të Azerbajxhanit presin, që në të ardhmen, njerëzit do të investojnë paratë e tyre në këtë mënyrë më shumë sesa në banka.

Estoni

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve i Estonisë e mbylli gjysmën e parë të vitit 2013 me një rritje mbresëlënëse të primeve të shkruara bruto. Sipas të dhënave të siguruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Estoni, volumi i primeve të shkruar bruto arriti në 217.55 milion euro, ose 23.6% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një vitit më parë.



Greqi

www.xprimm.com

Sipas vlerësimeve të FMN-së, ekonomia greke do të tkurret përsëri gjatë këtij viti. Kjo do të vërtetohet si nga niveli në rënie i GDP-së, niveli i ulët i konsumit privat dhe shkalla e papunësisë, e cila në fund të vitit 2013 pritet të jetë 27% në krahasim me 7.7% që ka qenë në vitin 2008 (sipas statistikave të FMN-së).



Sipas vlerësimeve të FMN-së, ekonomia greke do të tkurret përsëri gjatë këtij viti

Lidhur me tregun e sigurimeve, siguruesit greke raportuan një vlerë prej 1.98 miliard euro të primeve të shkruara bruto për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013. Sipas raportit të botuar nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (HAIC), kjo shifër është 11% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013 sigurimi i Jo-Jetës zuri 59% të totalit të primit të sigurimeve, ndërkohë që sigurimi i Jetës zuri pjesën e mbetur të tregut.

Hungari

www.xprimm.com

Tregu hungarez i sigurimeve regjistroi një normë pozitive rritjeje në terma realë të volumit të primeve të shkruara bruto prej 4.72% për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013. Megjithatë Shoqata e Siguruesve të Hungarisë (MABISZ), e ka cilësuar këtë si një rritje mjaft të brishtë.



Tregu hungarez i sigurimeve regjistroi një normë pozitive rritjeje në terma realë të volumit të primeve të shkruara bruto prej 4.72% për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013

Sigurimi i Jetës zuri 54% të volumit të primeve të shkruara bruto në marrjen në sigurim, një vlerë në monedhën kombëtare prej 231.7 miliard HUF (rreth 784.4 milion euro) ose 9.95% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimi i Jo-Jetës realizoi 204.2 miliard HUF (rreth 667.4 milion euro), duke shënuar ulje me 0.8% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2012.

Tendenca e vazhdueshme negative në sigurimet e Jo-Jetës është kryesisht pasojë e tkurrjes së pandërprerë në sigurimin e automjeteve. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 sigurimi Kasko u tkurr me 12.3%, ndërsa në klasën e MTPL primi i shkruar u ul me 2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas shoqatës MABISZ, këto rezultate janë pjesë e një tendence afatgjatë, të lidhur pjesërisht me rënien e madhe në shitjet e makinave të reja dhe si rezultat të ardhurat nga primet e sigurimeve të automjeteve janë zvogëluar nga 53% në 40% të totalit të volumit në segmentin e Jo-Jetës, në më pak se 6 vjet.

Letoni

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të siguruara nga Zyra Statistikore e FKTK e Letonisë, tregu i sigurimeve në vend është rritur me 7%. Kjo i dedikohet kryesisht rritjes së vazhdueshme të ekonomisë dhe konsumit. Volumi i primeve të shkruar bruto nga kompanitë e sigurimeve, pati një rritje për pothuajse të gjithë llojet e sigurimeve dhe me veçanërisht në sigurimin e Jetës i cili u rrit me 23%. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, primet e shkruara bruto arritën 168 milionë LVL, monedha kombëtare ose (rreth 239 milion euro).



Turqi

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve turke pësoi rritje në volumin e primeve të shkruara bruto me rreth 25%

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, tregu i sigurimeve turke pësoi rritje në volumin e primeve të shkruara bruto me rreth 25%. Shoqata e Siguruesve, Risiguruesve dhe Kompanive të Pensioneve të Turqisë njoftoi se volumi i primeve të shkruara bruto për gjashtëmujorin e parë të 2013 arriti në rreth 5 miliardë euro. Megjithë këtë trend pozitiv, përqindja e tregut të sigurimeve në totalin e Produktin e Brendshëm Bruto, PBB, ka mbetur pothuaj në një nivel të ulët, 1.37%. Parashikimet janë që në fund të vitit 2013 ky tregues do të përmirësohet në rritje deri afro 1.45 %.



Gjatë vitit 2012 ka pasur ndryshime të bëra në Ligjin e Sigurimeve ndaj Katastrofave Natyrore. Pas këtyre reformave, shitja e policave të sigurimit nga tërmeti u rrit me 48% në terma vjetorë, ndërkohë që shkalla e penetrimit arriti në 35%, duke u rritur me 10%. Përsa i përket reformës së pensioneve private, sistemi i ri stimulues, i cili hyri në fuqi nga janari 2013, ka ndihmuar në pothuajse dyfishimin e normën së regjistrimit në këto skema pensionesh.

Për këtë numër punuan:

**R. Guri, D. Kalaja, P. Berberi, R. Eltari, Dh. Hazbiu,
E. Beqir-Aga, E. Valera, E. Kokona**